L I G J
Nr.8492, datë 27.5.1999

PËR TË HUAJT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, qarkullimit, punësimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, si dhe të daljes së tyre prej territorit të saj.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji termat vijuese kanë këto kuptime:

"I huaj" – është çdo person, i cili sipas legjislacionit shqiptar nuk është shtetas shqiptar;

"azilkërkues" – është çdo person i quajtur i tillë nga ligji nr.8432, datë 14.12.1998 "Për Azilin";

"refugjat" – është çdo person i quajtur si i tillë nga ligji 8432, datë 14.12.1998 "Për Azilin";

"pjesëtarë të familjes" – janë:

a) Bashkëshorti ose bashkëshortja (vlefshmëria e martesës përcaktohet sipas ligjit të vendit të lidhjes së martesës);

b)prindërit, njerku, njerka;

c)fëmijët nën 18 vjeç, të pamartuar dhe që bashkëjetojnë me prindërit;

ç) anëtarë të tjerë të familjes të cilët bashkëjetojnë ligjërisht;

"vizë" – është autorizim zyrtar i lëshuar nga autoritetet shqiptare një të huaji, për të hyrë në Republikën e Shqipërisë;

"kërkesë paraprake e detyruar për vizë" – nënkupton kërkesën e shtetasit të huaj për të marrë vizën para se të paraqitet në kufirin e Republikës së Shqipërisë;

"leje qëndrimi" – është dokumenti dhënë të huajit për të qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë;

"pasaportë për të huajt" – quhet dokumenti i udhëtimit, dhënë shtetasve të huaj nga organet kompetente shqiptare, për të mundësuar udhëtimin jashtë shtetit, por që nuk është provë e identitetit të shtetësisë;

"leje pune" – quhet autorizimi i dhënë nga organi përkatës kompetent një të huaji, për motive biznesi, për t'u punësuar ose për t'u vetëpunësuar;

"kërkesë për azil" – është kërkesa për njohje të statusit të refugjatit, sipas akteve ndërkombëtare përgjithësisht të pranuara;

“transportues” – do të quhet çdo person fizik ose juridik që me rrugë ajrore, tokësore ose detare transporton e sjell shtetas të huaj në Republikën e Shqipërisë;

“garanci pasurore” – nënkupton shumën e nevojshme financiare që depozitohet nga vetë personi i huaj ose një person tjetër përkundrejt një detyrimi që mund të lindë si pasojë e një veprimi apo mosveprimi të pritshëm të personit të huaj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

“autoritet imigracioni” – nënkupton të gjitha ato organe përkatëse kompetente që kanë detyra në zbatim të këtij ligji;

“rezident” – quhet shtetasi i huaj, i cili disponon leje qëndrimi lëshuar sipas këtij ligji nga autoritetet e imigracionit;

“garant” – quhet shtetasi shqiptar ose rezidenti i huaj në Shqipëri, i cili deklarohet nëpërmjet një dokumenti legal se merr përsipër përgjegjësitë për qëndrimin e të huajit në Shqipëri dhe largimin e tij kundrejt dispozitave të këtij ligji;

“person i padëshirueshëm” – nënkupton një person të huaj, i përcaktuar si i tillë nga Ministri i Rendit Publik ose një instancë tjetër e autorizuar prej tij, në bazë të dispozitave të këtij ligji, hyrja ose qëndrimi i të cilit në Republikën e Shqipërisë konsiderohet në dëm të interesave të sigurimit kombëtar, sigurimit publik, shëndetit e moralit publik dhe të interesave të tjera të rëndësishme kombëtare;

“urdhri i largimit” – nënkupton urdhrin për largimin e një të huaji nga territori i Republikës së Shqipërisë për shkak se qëndrimi i tij nuk është më i ligjshëm;

“nxjerrja jashtë” – nënkupton largimin me urdhër, largim me forcë ose dëbim;

“largim me forcë ose dëbim” - nënkupton tërësinë e masave për largimin e detyruar të të huajit prej Republikës së Shqipërisë nga autoritetet e policisë;

“policia” – është autoriteti kompetent në përbërje të strukturave policore të Ministrisë së Rendit Publik, me atributet e policisë gjyqësore për kundërvajtjet që përcaktohen në këtë ligj.

Neni 3
Parimet bazë

Ky ligj njeh dhe respekton parimet e normat përgjithësisht të pranuara të akteve ndërkombëtare, parimin e reciprocitetit, parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe interesat e sigurimit kombëtar e publik.

Neni 4
Personat e padëshiruar

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj, personat e huaj do të konsiderohen të padëshirueshëm dhe do t’u refuzohet kërkesa për hyrje, vizë ose leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë kur:

1. veprojnë ose propagandojnë kundër sovranitetit, sigurimit kombëtar, rendit kushtetues dhe sigurimit publik;

2. janë dënuar për krime për të cilat ligji parashikon një dënim jo më pak se pesë vjet burg;

3. janë anëtarë të organizatave terroriste ose të organizatave që cenojnë rendin kushtetues, si dhe kur përkrahin veprime që i kundërvihen çdo forme të organizuar qeverisjeje;

4. kërkohen nga organe ndërkombëtare për krime kundër njerëzimit, krime të kryera në kohë lufte ose krime të tjera të rënda;

5. përbëjnë kërcënim ose cenojnë marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me shtete të tjera;

6. ka dyshime të bazuara se do të hyjnë ose qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të kryer një krim ose përbëjnë kërcënim për shtetin;

7. janë të përfshirë në krimin e organizuar, në prostitucion, në trafik droge në trafikun

ilegal të klandestinëve në Republikën e Shqipërisë ose kalimin tranzit të tyre, si dhe në çdo trafik tjetër të paligjshëm;

Ndalimet, për personat e përmendur më sipër, për të hyrë në Republikën e Shqipërisë janë për një periudhë jo më pak se dhjetë vjet nga data e shpalljes "person i padëshirueshëm".

Kur personat e huaj, kanë kryer veprime që përbëjnë kufizime sipas paragrafit 1 të këtij neni, para se të mbushin moshën 18 vjeç, kanë të drejtë të kërkojnë nga Ministri i Rendit Publik të rishikohet kërkesa e tyre për hyrje, vizë ose leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Raste të refuzimit të hyrjes, vizës dhe lejes së qëndrimit

Kërkesa për hyrje, vizë dhe leje qëndrimi mund të refuzohet për personat e huaj në rastet kur:

1. janë përdorues droge;
2. janë alkolistë kronikë ose persona me sëmundje të rënda ngjitëse;
3. aplikojnë ose propagandojnë prostitucionin ose akte të tjera që vijnë në kundërshtim me moralin publik dhe janë të dënueshme me ligj;
4. kanë shkelur ose shkelin dispozita të legjislacionit shqiptar;
5. punojnë pa pasur leje pune ose pranojnë të punësojnë të huaj pa leje pune;
6. janë larguar nga vendi me shpenzime publike ose kanë detyrime të tjera financiare ndaj shtetit ose shtetasve shqiptarë, të cilat nuk i kanë shlyer;
7. janë qytetarë të një shteti me të cilin Republika e Shqipërisë është në gjendje lufte, në konflikt, ka tensione politike serioze ose të një shteti që dyshohet për terrorizëm kundër Republikës së Shqipërisë;
8. janë të dëbuar dhe kërkojnë të hyjnë ose qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë gjatë kohës kur vendimi i dëbimit është ende në fuqi;
9. vijnë nga zona epidemike dhe nuk kanë kartelën e plotë të vaksinimit;
10. nuk kanë pasaportë ose dokument tjetër,sipas nenit 9 të këtij ligji, që të vërtetojë identitetin dhe shtetësinë ose rezulton se kanë paraqitur të dhëna e dokumente të rreme;
11. kanë probleme të rënda psikike dhe janë të pashoqëruar nga kujdestarët e tyre.

Rastet e parashikuara në paragrafin 1 pika 7 e këtij neni përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Rendit Publik.

Për ndalimet e parashikuara në këtë nen mund të bëhet përjashtim vetëm për arsye humanitare.

Neni 6

Hyrja e të miturve

Personat nën 16 vjeç mund të aplikojnë për vizë leje ose të kërkojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë me lejen e kujdestarëve ligjorë dhe të shoqëruar nga persona madhorë. Bëjnë përjashtim personat që hyjnë si azilkërkues.

Neni 7

Marrja e vendimeve në lidhje me të huajt

Vendimet në lidhje me të huajt merren në bazë të ligjit, të rrethanave të njohura ose informacionet që mund të merren nga autoritetet shqiptare, duke marrë në konsideratë motivet e hyrjes ose të qëndrimit, mjetet e jetesës së të huajit në Republikën e Shqipërisë dhe arsyet për të cilat i huaji nuk duhet të hyjë ose të qëndrojë në Shqipëri.

Çdo vendim apo leje në lidhje me të huajt mund të anulohet kur nuk ekzistojnë më arsyet

mbi të cilat është marrë ky vendim ose ndryshojnë kushtet në bazë të të cilave u bë i mundur lëshimi i kësaj lejeje ose për shkak të pranisë së disa faktorëve të rinj që nuk lejojnë hyrjen apo qëndrimin e të huajit në Republikën e Shqipërisë.

Ministri i Rendit Publik në raste të veçanta, për interesa të rëndësishme të shtetit, të sigurimit kombëtar e të rendit publik, me vendim të arsyetuar mund të bëjë përjashtime lidhur me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë ligj, duke marrë të gjitha masat e duhura për shmangien e pasojave negative, që mund të sjellë ky veprim.

KREU II
HYRJA DHE DALJA NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8
Vendi i hyrjes

Personat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të kalojnë vetëm nëpërmjet Pikave të Kalimit – Kontrollit Kufitar (PKKK).

Neni 9
Kushtet e hyrjes

Të huajt duhet të plotësojnë këto kushte për të hyrë në Republikën e Shqipërisë:

1. Të disponojnë një nga dokumentet e mëposhtëm:

a) pasaportë ose dokument tjetër të vlefshëm udhëtimi që mundëson vërtetimin e identitetit të shtetësisë së personit, i cili të jetë i vlefshëm deri 6 muaj pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë dhe të njihet nga autoritetet shqiptare;

b) kartë identiteti për qytetarët e atyre vendeve, të cilëve me akte nënligjore në zbatim të këtij ligji, u lejohet hyrja me këtë dokument;

c) leje-kalimi të OKB-së e filialeve të saj, Këshillit të Europës, Bashkimit Europian, NATO-s dhe organizmave të tjerë të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatimin e këtij ligji;

ç) leje-kalimi për fëmijët nën 16 vjeç.

2. Të disponojë lejen e dhënë nga autoritetet shqiptare si vizë ose leje qëndrimi. Të huajve mund t'u kërkohet të disponojnë edhe dokumentet e nevojshme në bazë të të cilave është lëshuar viza ose që mbështesin motivin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Shtetasit e huaj, që në bazë të përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji, të cilët lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, konsiderohet se e zotërojnë lejen për të hyrë në Republikën e Shqipërisë.

3.Të vërtetojnë se disponojnë mjete të mjaftueshme jetese, në bazë të të cilave krijojnë besueshmëri dhe provojnë se nuk do t’u drejtohen fondeve publike për të siguruar jetesën në Shqipëri. Si provë e tillë do të shërbejnë: biletë kthimi, vizë në destinacion, rezervim hoteli për turistë, biletë qarkullimi turistike, certifikatë biznesi, korrespondencë biznesi, fatura transporti e eksporti, mjete jetese si çek, kartë krediti, konfirmim banke, kesh, konfirmim për pagën, deklaratë mbështetëse nga një garant në Shqipëri, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji etj.

Kërkesat e pikës 3 të këtij neni nuk aplikohen për një të huaj që do të takojë pjesëtarë të familjes, që janë shtetas shqiptarë, të huaj rezidentë në Republikën e Shqipërisë ose refugjatë.

4. Disponimi i vizës ose një dokumenti tjetër që autorizon hyrjen e të huajit në Republikën e Shqipërisë, nuk është më i vlefshëm si i tillë nëse i huaji konsiderohet i padëshirueshëm ose i zhvleftësohet, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 10
Pjesëtarët e ekuipazheve të huaja

Pjesëtarët e ekuipazhit të një mjeti transporti, që vepron mbi baza të ligjshme në Shqipëri, do të çlirohen nga disa kufizime e kërkesa të këtij ligji, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 11
Detyrimi i ripranimit

Në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshje ripranimi që ka nënshkruar Republika e Shqipërisë, ripranohen të huajt e dëbuar nga shtete të tjera të nisur nga Republika e Shqipërisë.

Neni 12
E drejta për të qëndruar në pikat e tranzitit

Në rast refuzimi hyrjeje, i huaji mund të qëndrojë tek tranziti i Pikës së Kalim-Kontrollit Kufitar (PKKK) deri në largimin përfundimtar dhe në rast ankimi ose kërkim azili, siç përcaktohet në këtë ligj, deri në shqyrtimin e tyre. Shqyrtimi i ankimit për rastet që përcaktohen në këtë nen bëhet brenda 48 orësh nga refuzimi.

Neni 13
Dalja nga Republika e Shqipërisë

Çdo i huaj është i lirë të largohet nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur:

1. kërkohet nga autoritetet shqiptare për shkak se ka kryer ose dyshohet se ka kryer një vepër penale;
2. kërkon të largohet drejt një shteti tjetër dhe nuk ka vizë ose leje për të hyrë në atë shtet.

KREU III
VIZAT, LEJET E QËNDRIMIT

VIZAT

Neni 14
Kërkesa për vizë

Të huajt, të cilët duhet t'i nënshtrohen një kërkese paraprake për vizë, duhet të ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në momentin e aplikimit.

Kërkesa për vizë bëhet pranë përfaqësive të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Nëse nuk ka përfaqësi shqiptare në vendin e aplikantit ose në vendin ku ai/ajo është rezident, kërkesa mund të bëhet në përfaqësinë shqiptare në vendin fqinjë. Nëse edhe kjo nuk është e mundur për shkak të distancës, kërkesa mund të bëhet nga pala e interesuar te Drejtoria Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe viza jepet në kufi.

Për fëmijët nën 16 vjeç, kur nuk janë të pajisur me pasaportë vetjake, viza mund të shënohet tek viza e prindit ose e kujdestarit ligjor, në pasaportën e të cilit fëmija është i regjistruar.

Neni 15

Kompetencat e titullarit të përfaqësisë diplomatike

Titullari i përfaqësisë së Republikës të Shqipërisë jashtë shtetit ka të drejtë të japë miratimin për viza diplomatike, shërbimi, turistike, mjekësore, pune e tranziti për rastet e mëposhtme:

1. Për personalitete të shquara të jetës politike, shoqërore, kulturore, ekonomike të vendit ku janë.

2. Për delegacione të huaja që vijnë me ftesë të ministrive ose të institucioneve të tjera të barazvlefshme me to, bashkive e prefekturave.

3. Për raste urgjente humane (vdekje, aksidente ose sëmundje të rënda të papritura.

4. Për pjesëtarë të familjeve (prindër, fëmijë, motra, vëllezër) të diplomatëve të huaj në Tiranë.

5. Për personat e pajisur me dokument udhëtimi të organizatave dhe institucioneve të mirënjohura ndërkombëtare.

Për raste të tjera që nuk janë përcaktuar më sipër, titullari i përfaqësisë merr më parë miratimin e Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila nga ana e saj duhet të konsultohet me autoritetin kompetent pranë Ministrisë së Rendit Publik

Kompetencat e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni mund të pezullohen vetëm me urdhër të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 16

Afatet, numri i kalimeve dhe zgjatja e kohëqëndrimit të vizës

Viza përmban afatin e përdorimit të saj, që nënkupton afatin brenda së cilës personi i huaj ka të drejtë të përdorë vizën për të hyrë në Shqipëri. Afati i përdorimit mund të jetë:

1.tre muaj;

2.gjashtë muaj;

3.një vit.

Afati i përdorimit të vizës fillon në datën e lëshimit të saj.

Në vizë përcaktohet gjithashtu edhe afati i qëndrimit, i cili varion nga 1 deri në 90 ditë. Afati i qëndrimit fillon ditën që i huaji hyn në Shqipëri. Vizat me afat përdorimi mbi tre muaj mund të jenë me shumë kalime.

Viza zgjatet një herë me gjysmën e periudhës së parë nga përfaqësia e Republikës së Shqipërisë ose autoriteti kompetent, përcaktuar në këtë ligj.

Afati i përdorimit dhe i qëndrimit, numri i hyrjeve e tarifa mund të ndryshojnë për qytetarë të vendeve të veçanta në varësi të reciprocitetit.

Neni 17

Kushtet për miratimin e vizës

Për miratimin e vizës duhet të plotësohen kushtet si më poshtë:

1. Shtetasi i huaj të jetë i pranueshëm për të hyrë e qëndruar në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në nenet 4 e 5 të këtij ligji e në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Shtetasi i huaj të disponojë një dokument udhëtimi, vlefshmëria e të cilit e kapërcen të paktën tre muaj afatin e përdorimit dhe të qëndrimit të vizës.

3. I huaji të motivojë arsyen e vizitës në Shqipëri.

4. Të ketë mjete të mjaftueshme jetese që të mos ketë nevojë t'u drejtohet fondeve publike.

Nëse i huaji ka qenë më parë i larguar, para miratimit të vizës, duhet konsultuar edhe me

autoritetin e dëbimit.

Neni 18
Llojet e vizave

Viza mund të jetë individuale ose kolektive për raste grupesh me jo më pak se dhjetë persona.

Autoritetet shqiptare lëshojnë këto lloje vizash:

1. Vizë diplomatike jepet për diplomatë e zyrtarë të lartë, si dhe për vizita private për personalitetet me rang jo më të ulët se ai i ministrit.

Viza diplomatike mund të refuzohet vetëm pas konsultimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Viza diplomatike jepet falas me përjashtim në rastet kur aplikohet reciprociteti.

2. Vizë shërbimi jepet për zyrtarë ose persona që vijnë në Republikën e Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit me institucionet tona publike.

3. Vizë e thjeshtë e cila ndahet në kategoritë e mëposhtme:

a) Vizë turistike jepet për të huaj që vijnë në Republikën e Shqipërisë për turizëm, vizita etj. Afati i përdorimit të saj nuk duhet të kalojë 6 muaj me gjithë zgjatjen. I huaji që disponon këtë vizë ndalohet kategorikisht të punojë ose të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.

b) Vizë studimi jepet për të huajt që synojnë të ndjekin kurse ose shkolla të ndryshme në Republikën e Shqipërisë. Afati përcaktohet në varësi të afatit të studimeve.

c) Vizë pune jepet për të huajt që do të kryejnë një veprimtari fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë.

ç) Vizë mjekësore jepet për të huajt që duan të kryejnë vizita mjekësore ose të kurohen në Republikën e Shqipërisë.

d) Vizë tranzit e cila lejon qëndrimin vetëm për 48 orë ose për një kalim tranzit dhe nuk lejon që i huaji të punojë apo të ushtrojë veprimtari. Kjo lloj vize mund të jetë me një, dy apo më shumë kalime.

dh) Vizë me afat qëndrimi 72 orë u jepet atyre shtetasve të huaj të cilët janë të detyruar të bëjnë kërkesë paraprake për vizë, por që për arsye të jusitifikueshme janë paraqitur në Pikën e Kalim-Kontrollit Kufitar (PKKK) pa vizë. Kjo vizë jepet nga autoritetet e Drejtorisë Vendore të Policisë. Të huajt që marrin këtë vizë kanë të drejtë që brenda këtij afati të bëjnë kërkesë për marrjen e një lloj vize tjetër.

4. Vizë qëndrimi jepet për shtetasit e huaj që parashikojnë të qëndrojnë më tepër se tre muaj në Republikën e Shqipërisë.

Vizat e përcaktuara nga pikat 1 deri 3 të këtij neni, përveç vizës së përcaktuar në pikën 3(b), jepen vetëm për rastet kur personat e huaj parashikojnë të qëndrojnë jo më shumë se tre muaj në Republikën e Shqipërisë.

LEJET E QËNDRIMIT

Neni 19
Kushtet për të aplikuar për leje qëndrimi

Kanë të drejtë të kërkojnë leje qëndrimi:

1. shtetasit e huaj që lejohen të hyjnë pa vizë në Shqipëri;

2. shtetasit e huaj të pajisur me vizë qëndrimi.

Kërkesa për leje qëndrimi bëhet pranë autoriteteve kompetente në Ministrinë e Rendit Publik. Kërkesa nuk është e vlefshme nëse i huaji largohet para se të merret vendimi.

Neni 20

Kohëzgjatja e lejeve të qëndrimit

Lejet e qëndrimit mund të jenë:

1. 3-mujore
2. 6-mujore
3. njëvjeçare
4. 5-vjeçare;
5. e përhershme.

Një leje qëndrimi 3-mujore, 6-mujore e njëvjeçare mund të rinovohet jo më shumë se tre herë rradhazi.

Një person i huaj mund të aplikojë për leje 5-vjeçare qëndrimi nëse ka pasur qëndrim të ligjshëm për 2 vjet radhazi në Republikën e Shqipërisë dhe ka lidhje ose veprimtari të qëndrueshme.

Neni 21

Kushtet për t'u pajisur me leje qëndrimi dhe ripërtëritja e saj

Të huajt mund të pajisen me leje qëndrimi nëse:

1. plotësojnë kushtet e neneve 4, 5 e 8 të këtij ligji;
2. kanë kushte e mjete të përshtatshme jetese;
3. janë në gjendje të argumentojnë motivin e qëndrimit, përshtatshmërinë e tyre për të kryer veprimtarinë e parashikuar;
4. janë në gjendje të argumentojnë angazhimin e tyre të plotë, si dhe nevojën për këtë angazhim në veprimtarinë për të cilën kërkojnë lejen e qëndrimit.

Kërkesa për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit bëhet një muaj para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese. Ajo ripërtërihet brenda një muaji, nëse rrethanat kryesore të dhënies së lejes së mëparshme nuk kanë ndryshuar.

Neni 22

Kufizimet në lejen e qëndrimit

Leja e qëndrimit mund të lëshohet edhe me kufizime, duke pasur parasysh motivet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, të cilat përcaktohen me akte për zbatim të këtij ligji në interes të sigurimit kombëtar e të rendit publik. Këto kufizime mund të ndryshohen me kërkesë të të huajit ose me ndryshimin e kushteve.

Të huajit mund t'i anulohet leja e qëndrimit, nëse qëndron jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj për disponuesit e lejeve njëvjeçare, 6 muaj për disponuesit e lejeve 5-vjeçare dhe 2 vjet për të huajit me leje qëndrimi të përhershme. Të huajt mund të kërkojnë një afat më të gjatë për qëndrim jashtë shtetit, nëse bëjnë kërkesë paraprakisht tek autoritetet vendore të imigracionit.

Këshilli i Ministrave përcakton kushtet financiare e të biznesit për investitorët, tregtarët, biznesmenët, partnerët tregëtarë dhe të vetëpunësuarit e huaj, në lidhje me marrjen e lejes së qëndrimit.

Neni 23

Leja e qëndrimit si rezultat i bashkimit familjar

Një i huaj lejohet të aplikojë për leje qëndrimi për shkak të bashkimit familjar, nëse një nga pjesëtarët e familjes është shtetas shqiptar, refugjat ose i huaj rezident me leje qëndrimi jo më pak se një vit.

Nëse personi rezident në Shqipëri ka më tepër se një bashkëshorte, i duhet të zgjedhë vetëm njërën prej tyre.

Pranohet si kërkesë për leje qëndrimi kërkesa e një të huaji për bashkim familjeje për shkak bashkëjetese pa martesë me një person të huaj rezident në Shqipëri, nëse në vendin e njërit prej aplikantëve bashkëjetesa pa martesë mes dy personash të sekseve të kundërt, pranohet si e ligjshme. Bashkimi familjar nuk konsiderohet argument për t'i dhënë leje qëndrimi një shtetasi të huaj, nëse martesa ose adoptimi është kryer pas një urdhri largimi ose vendim refuzimi për të.

Neni 24

Kushtet për leje të përhershme qëndrimi

Një person i huaj mund të kërkojë leje të përhershme qëndrimi kur:

1. ka arsye për bashkim familjar, në rast se një pjesëtar i familjes është shtetas shqiptar ose rezident i përhershëm. Bashkëshortët duhet të kenë bashkëjetesë mbi një vit në Republikën e Shqipërisë;

2.ka pasur leje qëndrimi pesëvjeçare dhe ka lidhje ose veprimtari të qëndrueshme në Republikën e Shqipërisë.

Mund të kërkojnë leje qëndrimi të përhershme edhe ata persona të huaj, që kanë kontribuar për interesat tona kombëtare. Ministri i Rendit Publik vendos nëse mund të çlirohen nga disa kufizime ose kërkesa për miratimin e lejes së qëndrimit.

KREU IV

LEJET E PUNËS

Neni 25

Detyrimi për t'u pajisur me leje pune

Personat fizikë ose juridikë, që nuk janë shtetas shqiptar, kur dëshirojnë të punojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat kohor mbi 3 muaj, duhet të pajisen me leje pune të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 26

Mënyra e paraqitjes së kërkesës për leje pune

Kërkesa për pajisje me leje pune bëhet me shkrim përpara fillimit të punës, duke plotësuar formularët zyrtarë përkatës.

Formularët e kërkesave mund të merren në Drejtorinë e Migracionit, në ambasadat ose konsullatat tona jashtë ose pranë zyrave rajonale të punës.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale përcakton formularin tip të lejeve të punës, procedurat përkatëse për marrjen, përsëritjen dhe refuzimin e lejes së punës, si dhe mënyrën e bërjes së kërkesës dhe dokumentet e nevojshme që duhen paraqitur.

Neni 27

Organet kompetente për dhënien e lejes së punës

Organi kompetent për dhënien e lejeve të punës është zyra e punës e njësisë së qeverisjes vendore, ku i huaji kërkon të ushtrojë veprimtarinë e tij.

Kur ushtrimi i veprimtarisë së të huajit shtrihet në më tepër se një njësi vendore, leja e punës do të jepet nga Drejtoria e Migracionit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 28
Vendi i ushtrimit të veprimtarisë

Njësi e qeverisjes vendore, ku i huaji ushtron veprimtarinë e tij, do të quhet ajo ku ka selinë ndërmarrja ose zyra ku i huaji është i punësuar ose i vetëpunësuar.

Kur i huaji ushtron veprimtarinë e tij në njësi të ndryshme, vendi i ushtrimit të veprimtarisë së punës do të jetë ai ku të huajit i bëhet pagesa ose ku i vetëpunësuari ka qendrën.

Neni 29
Kërkesa për leje pune, kur i huaji nuk ka hyrë në Republikën e Shqipërisë

Kur punëmarrësi banon në një vend të huaj dhe është subjekt i kërkesës paraprake për vizë, kërkesa për leje pune bëhet nga punëdhënësi pranë zyrës përkatëse të punës.

Pas marrjes së miratimit përkatës, punëdhënësi i paraqet dokumentet individuale të punëmarrësit, të përkthyera në shqip dhe të noterizuara, pranë Drejtorisë së Migracionit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Drejtoria e Migracionit e dërgon këtë leje pune në ambasadën ose zyrën konsullore të Republikës së Shqipërisë në vendin e banimit me të afërt të punëmarrësit.

Neni 30
Afati për dhënien ose refuzimin e lejes së punës

Afati për dhënien ose refuzimin e lejes së punës është jo më shumë se 30 ditë nga data e paraqitjes së dokumentacionit pranë organit kompetent. Në rastet e parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, ky afat shkon deri në 60 ditë.

Neni 31
Dhënia e lejes së punës për herë të parë

Për një punësim që bëhet për herë të parë leja e punës për të huajt do të jepet e kufizuar në kohë.

Neni 32
Nevojat e tregut

Leja e punës për shtetasit e huaj do të jepet duke mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 33
Përparësia në dhënien e lejes së punës

Leja e punës do të jepet pa marrë parasysh gjendjen dhe zhvillimet e tregut të punës dhe pa kufizime sipas nenit 34 të këtij ligji, nëse i huaji:

1. është bashkëkort/e i një shtetasi/e shqiptar, zotëron një leje qëndrimi dhe për sa kohë bashkëshorti vazhdon jetën bashkëshortore;

2. ka përfunduar një shkollë të mesme profesionale shtetërore ose private, të njohur si e tillë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 34
Kufizimet e lejeve të punës në kohë dhe sipas profesionit

Leja e punës mund të jetë e kufizuar ose jo në kohë.

Leja e punës mund të jetë e kufizuar për ushtrimin e një profesioni të caktuar në një subjekt të caktuar.

Leja e punës mund të jetë edhe pa kufizime në ushtrimin e një profesioni të caktuar në një subjekt të caktuar.

Neni 35

Shtrirja në hapësirë e lejeve të punës

Leja e punës, e lëshuar sipas nenit 34 paragrafi 2 të këtij ligji, ka vlefshmëri vetëm në kufijtë administrativë që mbulon zyra e punës që ka lëshuar miratimin e saj.

Leja e punës e lëshuar sipas nenit 34 paragrafi 3 të këtij ligji, ka vlefshmëri të pakufizuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 36

Shtrirja në kohë e lejeve të punës

Leja e punës lëshuar sipas nenit 34 paragrafi 2 të këtij ligji ka vlefshmëri deri në afatin kohor njëvjeçar.

Leja e punës lëshuar sipas nenit 34 paragrafi 3 të këtij ligji ka vlefshmëri deri në afatin kohor pesëvjeçar.

Neni 37

Llojet e lejeve të punës

Leje pune e tipit A i jepet të huajve për një kohë jo më shumë se 6 muaj.

Leje pune e tipit B i jepet të huajve për t'u punësuar në një profesion të caktuar në një zonë gjeografike të caktuar në një punëdhënës të caktuar.

Leja e punës e tipit B jepet për një periudhë njëvjeçare.

Ky tip leje pune mund të ripërtërihet për një afat kohor njëvjeçar, kur nuk kanë ndryshuar rrethanat kryesore të dhënies së lejes së punës të mëparëshme.

Leje pune e tipit C i jepet të huajve rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që kanë marrë leje pune të tipit B, vlefshmëria totale e të cilave kap afatin kohor minimal 3-vjeçar, gjatë një periudhe të vazhduar banimi. Leje pune e tipit C u jepet të huajve për t'u punësuar në çdo veprimtari dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pa kufizime në punëdhënës të caktuar. Ky tip leje pune jepet për një afat kohor 5-vjeçar.

Leje pune e tipi D (leje vetëpunësimi) u jepet personave të huaj të vetëpunësuar, duke kufizuar veprimtarinë e tyre në një zonë gjeografike të caktuar. Kohëzgjatja e kësaj leje pune është një vit me të drejtë ripërtëritjeje.

Leje pune e tipit E (leje vetëpunësimi) u jepet personave të huaj të vetëpunësuar për çdo lloj veprimtarie dhe pa kufizime gjeografike, të cilat kanë marrë leje pune të njëpasnjëshme të tipit, vlefshmëria e të cilave ka afatin minimal tre vjet. Kjo leje pune është e vlefshme me afat kohor deri në pesë vjet.

Leje pune e tipit F (për Studentë) u jepet personave të huaj që studiojnë në Shqipëri për vitin mësimor në vazhdim. Kjo leje pune jepet vetëm për orare pune të reduktuara gjatë vitit mësimor dhe me orare të plota pune gjatë pushimeve midis viteve akademike apo simestrave.

Leje pune e tipit G u jepet të huajve që investojnë në Republikën e Shqipërisë dhe punësojnë jo më pak se dy shtetas shqiptarë për çdo shtetas të huaj të punësuar. Afati i kësaj lejeje është një vit me të drejtë ripërtëritjeje.

Leje pune e tipit H u jepet të huajve të cilët kanë pasur më parë leje të njëpasnjëshme të tipit G, vlefshmëria e të cilave kap afatin kohor minimal tre vjet. Leja e punës e tipit H jepet për

një afat kohor pesëvjeçar.

Neni 38
Mbarimi i lejes së punës

Leja e punës mbaron kur:
1. plotësohet afati kohor për të cilën ajo është lëshuar;
2. i huaji largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë për një periudhë mbi 6 muaj.

Neni 39
Ripërtëritja e lejes së punës

Kërkesa për ripërtëritjen e lejes së punës, përveç lejës së punës sezonale, bëhet një muaj para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese. Ajo ripërtërihet brenda një muaji nëse rrethanat kryesore të dhënies së mëparshme të lejes së punës nuk kanë ndryshuar.

Neni 40
Dokumenti zëvendësues i lejes së punës

Në rastet kur leja e punës humbet ose dëmtohet, ajo zëvendësohet me një leje pune të re.

Për periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e ripërtëritjes së lejes së punës, i huaji do të pajiset me një leje pune të përkohshme, me vlefshmëri nga koha e dorëzimit të lejes së vjetër deri në pajisjen e të huajit me leje pune të re.

Neni 41
Përjashtimet nga detyrimet për pajisje me leje pune

Përjashtohen nga pajisja me leje pune, kategoritë e mëposhtme:

1. përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike të organizatave ndërkombëtare me status diplomatik, si dhe të huaj që janë punonjës të këtyre përfaqësive;
2. përfaqësuesit e organizatave joqeveritare pa qëllime fitimi;
3. drejtorë ekzekutivë dhe punonjës të rëndësishëm të kompanive të huaja që kanë veprimtari apo që kanë qëllim të hapin veprimtari në Shqipëri;
4. punonjës dhe profesionistë të tjerë të një kompanie të huaj, që vijnë për të punuar në degët apo filialet e kësaj kompanie në Shqipëri;
5. specialistë të ardhur në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe;
6. personeli i transportit ndërkufitar i mallrave dhe njerëzve;
7. lektorë, pjesëtarë të stafeve shkencore, pedagogë të universiteteve, pjesëtarë të stafeve shkencore, të organizatave shkencore private, nëse ka interes publik, si shkak i njohurive të tyre të veçanta;
8. përfaqësues të mas-medias, korrespondentë ose reporterë, që punojnë për një punëdhënës të huaj;
9. studentë të universiteteve që marrin pjesë në një shkëmbim të punëve gjatë pushimeve veriore, si rezultat i marrëveshjeve përkatëse.

Neni 42
Përjashtime të tjera nga detyrimi për pajisje me leje pune

Nuk do të quhet se punon në Republikën e Shqipërisë personi, i cili është punonjës i një korporate të huaj, ruan banimin e tij jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kryen këtu për një kohë

jo më shumë se 6 muaj këto veprimtari:

1.Bën negociata për një shoqëri të huaj, përfundon marrëveshje apo përkujdeset për një pavion në një panair.

2.Punon në fushën e transportit.

3.Instalon makineritë apo konstruksionet, që dorëzohen nga një korporatë e huaj, bën shërbimin dhe riparimin e makinerive, si edhe trainimin e punonjësve shqiptarë ose të huaj për shfrytëzimin e tyre.

4.Bën trainimin për përdorimin e një makinerie, konstruksioni apo objekti tjetër, të cilat janë blerë nga një korporatë e huaj.

Neni 43
Shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes së punës

Leja e Punës do të refuzohet nëse:

1.gjendja e tregut shqiptar të punës nuk e lejon këtë punësim;

2.marrëdhëniet dhe kushtet e shprehura në kontratë nuk përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar, si dhe të konventave ndërkombëtare;

3.informacioni dhe dokumentet e kërkuara lihen qëllimisht të paplotësuara apo janë të rreme;

4. punëdhënësi i huaj ose shqiptar nuk përmbush detyrimin për të raportuar vendin e lirë të punës, sipas nenit 21 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”;

5. punëmarrësi i huaj nuk paraqet kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 38 të këtij ligji për ripërtëritjen e lejes së punës;

6. ka arsye të rëndësishme që përbëjnë rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 44
Ankimi

Në rast refuzimi të lejes së punës personi i interesuar njoftohet me shkrim.

Brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të refuzimit, ai mund të ankohet me shkrim te Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, i cili jep vendimin brenda dy javëve nga marrja e kërkesës.

Neni 45
Sanksionet

Sanksionet për shkeljen e dispozitave të këtij kreu vendosen sipas ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”.

KREU V
LARGIMI I DETYRUAR,TË DREJTAT DHE DETYRIMET

NXJERRJA JASHTË TERRITORIT

Neni 46
Urdhri i largimit

Nxjerrja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të një të huaji bëhet:

1.kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë;

2.kur i refuzohet viza;

3.kur i ka mbaruar afati i përdorimit dhe i qëndrimit të saj;

4.kur refuzohet ose mbaron vlefshmëria e lejes së qëndrimit.

Për rastet e parashikuara në pikat e këtij neni, autoriteti kompetent në Ministrinë e Rendit Publik lëshon urdhrin e largimit.

Neni 47

Dëbimi (largimi me forcë)

I huaji do të dëbohet (largohet me forcë) me urdhër të posaçëm të autoriteteve të Ministrisë së Rendit Publik kur:

1.nuk është larguar ose ka dyshime të bazuara se nuk do të largohet nga Republika e Shqipërisë, konform dispozitave të këtij ligji;

2.ka hyrë ose qëndron ilegalisht në Republikën e Shqipërisë;

3.është dëbuar nga një shtet tjetër dhe është ripranuar nga autoritetet shqiptare në bazë të detyrimeve ose marrëveshjeve të nënshkruara.

Neni 48

Vendi i largimit a dëbimit dhe e drejta e ankimit

I huaji largohet ose dëbohet në vendin nga ka ardhur, në vendin e lindjes, në vendin ku ka rezidencë ose në një vend tjetër që e pranon të huajin.

Kundër vendimit të largimit ose dëbimit, i huaji mund të bëjë ankim administrativ dhe në gjykatë.

Neni 49

Rastet e përjashtimit nga nxjerrja jashtë

Asnjë shtetas i huaj, me status refugjati apo gjatë shqyrtimit të kërkesës për azil, nuk do të nxirret jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë në drejtim të një vendi tjetër, ku jeta ose liria e tij kërcënohen për shkak të racës, bindjeve fetare, përkatësisë etnike, bindjeve politike ose përkatësisë në një grup politik apo social.

Gjithashtu, nuk do të nxirret jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë edhe ai person i huaj për të cilin ka arsye të besohet se i kërcënohet jeta në vendin ku do të dëbohet.

Neni 50

Rastet e dëbimit me urdhër të Ministrit të Rendit Publik

Nuk mund të dëbohen pa urdhër të Ministrit të Rendit Publik personat e huaj që:

1.kanë qënë rezidentë në Shqipëri që në moshën gjashtë vjeç;

2.kanë leje qëndrimi të përhershme;

3.janë pjesëtarë të familjes të shtetasve shqiptarë ose rezidentëve të përhershëm dhe që kanë të paktën 1 vit bashkëjetesë;

4.kanë banuar e ushtruar veprimtari në Republikën e Shqipërisë mbi 5 vjet;

5.janë invalidë të punës;

6.janë refugjatë.

Neni 51

Shtyrja e ekzekutimit të urdhrit të largimit

Ekzekutimi i urdhrit të largimit shtyhet deri në përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, vizës etj., si dhe deri në mbarimin e procedurës së ankimit, nëse i huaji e ka bërë atë brenda afateve e kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Shtyrja e ekzekutimit të urdhrit të largimit më tepër se 45 ditë lejohet vetëm me vendim të gjykatës që shqyrton kërkesën e të huajit për rishikimin e vendimit.

Neni 52

Ekzekutimi i menjëhershëm i urdhrit të largimit

I huaji mund t'i nënshtrohet ekzekutimit të menjëhershëm të një urdhri largimi, pavarësisht nga neni 56 i këtij ligji ose dëbohet për arsye garancie, kur:

1.është dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale;

2.i është refuzuar leja në bazë të neneve 4 e 5 të këtij ligji;

3.nuk është larguar brenda afatit;

4.nuk ka mjete banese e jetese;

5.nuk ka pasaportë ose dokument tjetër identifikimi;

6.ka deklaruar se nuk do të largohet pavarësisht nga vendimi i organeve kompetente;

7.ka mashtruar me të dhënat ose është me dokumente të falsifikuara;

8.ka dyshime të bazuara se do të largohet në drejtim të paditur;

9.arsyet e paraqitura nga i huaji për rishikimin e vendimit janë mbi baza abuzive.

Ekzekutimi i avancuar i urdhrit të largimit urdhërohet vetëm nga Ministri i Rendit Publik kur konsiderohet se qëndrimi i të huajit përbën një rrezik të menjëhershëm për Republikën e Shqipërisë.

Nuk urdhërohet largimi ose ekzekutimi i menjëhershëm i urdhrit të largimit, ose pezullohet nëse është dhënë një i tillë, kur i huaji paraqet arsye të bazuara që ky urdhër mund të përbëjë shkelje të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare , nënshkruar nga Republika e Shqipërisë.

Për rastet e përcaktuara në paragrafin e tretë të këtij neni, i huaji duhet të paraqesë brenda tre ditësh kërkesën për rishikimin e urdhrit, e cila duhet të shqyrtohet nga autoriteti përkatës në Ministrinë e Rendit Publik, jo më vonë se 8 ditë nga paraqitja e saj.

Neni 53

Largimi i të huajit në rastet kur ai ka kryer vepër penale

Procedura e ankimit kundër urdhrit për largim të një të huaji, që ka kryer vepër penale, duhet të marrë fund brenda periudhës që i huaji mbahet i ndaluar ose nën masa të tjera sigurie.

Në rast vuajtje dënimi, ekzekutimi i urdhrit të largimit kryhet menjëherë pas vuajtjes së dënimit.

Neni 54

Përmbajtja e urdhrit të largimit

Në urdhrin e largimit përcaktohet:

1.afati brenda të cilit duhet të largohet nga Republika e Shqipërisë;

2.afati brenda të cilit të huajit i ndalohet hyrja e qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, duke bërë edhe shënimin në pasaportë;

3.PKKK nga e cila i huaji do të largohet;

4.autorizimi i ekzekutimit të menjëhershëm;

5.marrja e shenjave të gishtërinjve.

Neni 55

Ekzekutimi i urdhrit të largimit

Largimi i të huajit, ndaj të cilit është lëshuar urdhri i largimit, bëhet nga policia.

Për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, nëse është e nevojshme, autoritetet e policisë bllokojnë të hollat ose mjete të tjera të të huajit.

Neni 56

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Ndaj urdhrit të largimit, refuzimit të çdo kërkese, masave ndëshkimore ose gjobave mund të bëhet ankim në organet e administratës ose në gjykatë, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Ankesa e të huajit në nivel administrativ shqyrtohet të paktën në një instancë më lart se ajo që shqyrtoi çështjen fillimisht. Gjatë shqyrtimit të kërkesës bëhet këshillim me organin që nxorri urdhrin e largimit ose vendimin e refuzimit. Me përjashtim të rasteve për vizat, për rishikimin e një vendimi që ka refuzuar dhënien e lejes së qëndrimit, personi i huaj paguan 50 për qind të tarifës së përcaktuar për lejen e qëndrimit.

Kundër vendimit të refuzimit ose urdhrit të largimit të dhënë mbas shqyrtimit nga organi administrativ, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 8 ditëve pas vendimit më të fundit administrativ, në rast se i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm jo më pak se një vit në Republikën e Shqipërisë.

Personat për të cilët urdhri i largimit është dhënë me vendim të Ministrit të Rendit Publik për arsyet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, nuk kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, përveçse lidhur me vendin e destinacionit. Para dhënies së një urdhri të tillë, Ministri i Rendit Publik këshillohet me Komitetin Këshillimor për të Huajt. Personi i huaj, objekt i këtij urdhri, njoftohet një javë para se të shqyrtohet çështja e tij dhe i jepet mundësia të bëjë përfaqësimin e çështjes së tij, të paraqesë ankesën e argumentet kundër urdhrit tek Ministri i Rendit Publik.

Shqyrtimi i ankesës së të huajit pezullon ekzekutimin e urdhrit të largimit të të huajit dhe familjes së tij, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji.

Kur të huajve u është lëshuar leje qëndrimi për shkak të bashkimit familjar, ankohet vetëm aplikanti kryesor. Mund të ankohen edhe fëmijët mbi 18 vjeç që nuk bashkëjetojnë me të, si dhe bashkëshorti ose bashkëshortja, që ka zgjidhur martesën para vendimit të refuzimit ose të largimit.

Për çështjet e imigracionit, për të cilat bëhet ankim në gjykatë, do të zbatohen rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë, për vetë karakterin e këtyre lloj çështjesh, shqyrtimi në të gjitha shkallët e gjykimit nuk mund të kalojë më shumë se 45 ditë (30 ditë gjykata e rrethit e 15 ditë gjykata e apelit).

Neni 57

Ankimi për refuzimin e hyrjes në kufi

Në rastet e refuzimi të hyrjes në kufi, i huaji ka të drejtë të bëjë ankim vetëm pasi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur:

1.është nga vendet, qytetarët e të cilave hyjnë pa vizë;

2.ka vizë;

3.kërkon azil.

Për rastet e përcaktuara në pikat “1” dhe “2”, ankesa e të huajit shqyrtohet brenda 48 orësh.

Neni 58

Detyrimi i të huajit për të provuar se është i përshtatshëm për të hyrë

Kur një i huaj ka bërë kërkesë për hyrje ose qëndrim në Republikën e Shqipërisë, është i detyruar të provojë se është i përshtatshëm për të hyrë e qëndruar në Republikën e Shqipërisë konform dispozitave të këtij ligji. Nëse nuk arrin të provojë një gjë të tillë, leja e kërkuar mund t’i

refuzohet.

Kur i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë detyrohet të tregojë nga ku ka hyrë, si dhe kohën e mënyrën e hyrjes. Nëse ai nuk i plotëson këto detyrime me prova, konsiderohet se ka hyrë ilegalisht.

Neni 59

Të drejtat dhe ndalimet për veprimtari të caktuara

Të huajt mund të merren me veprimtari sociale, politike, ekonomike, kulturore e bamirëse vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Kjo veprimtari u ndalohet në rast se:

1.cenon sigurimin kombëtar ose rendin publik;

2.cenon interesat apo marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me shtetet e tjera;

3.rrezikon ose dëmton marrëdhëniet ndërmjet shtetasve shqiptarë dhe të huaj ose ndërmjet grupeve të ndryshme të huajsh në territorin e Republikës së Shqipërisë;

4.nxit ose zbaton përdorimin e dhunës si mjet për të realizuar interesa politikë, fetarë etj.

Neni 60

Njoftimi i autoriteteve përkatëse nga organet gjyqësore dhe të administratës

Organet administrative dhe gjyqësore njoftojnë, sipas rastit, ato autoritete shtetërore që marrin detyra në zbatim të këtij ligji, për rastet si më poshtë:

1.Për arsye të përgjithshme përjashtimi, përcaktuar në nenin 4 e 5 të këtij ligji.

2.Për hapje procesi, vendime, masa, dënime, kufizime ose detyrime për të huajt.

3.Kur qëndrimi ose punësimi i të huajve është i paligjshëm.

4.Për shkeljen e një kufizimi të caktuar ligjor.

Neni 61

Njoftimi i policisë nga subjekte të tjera

Hotelet, pensionet, si dhe mjedise të tjera të kësaj natyre janë të detyruara të mbajnë regjistrin e personave të huaj që strehojnë, sipas rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore.

Të dhënat vetjake të një të huaji që janë marrë nga një mjek ose nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, duhet t'i bëhen të njohura menjëherë policisë pa kërkesë të këtyre të fundit, kur konstatojnë se:

1.i huaji rrezikon shëndetin publik dhe masat mbrojtëse për shmangien e pasojave nuk mund të plotësohen nga i huaji;

2.lidhen me arsye përjashtimi, përcaktuar në nenin 4 e 5 të këtij ligji.

Neni 62

Njoftimi në rast ndalimi ose arrestimi të të huajit

Në rast ndalimi ose arrestimi të të huajit, autoritetet e Ministrisë së Rendit Publik njoftojnë përfaqësinë diplomatike apo konsullore të vendit të tij ose zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët nëse është refugjat ose person pa shtetësi.

Njoftim mund të mos bëhet vetëm me vendim të Ministrit të Rendit Publik për arsye të forta të sigurimit kombëtar ose arsye reciprociteti.

Neni 63

Të drejtat e rezidentëve të përhershëm

Rezidentët e përhershëm nuk regjistrohen në polici por në gjendjen civile, dhe nëse plotësojnë kriteret, pajisen me kartë identiteti dhe pasaportë për të huajt.

Rezidentët e përhershëm mund të punësohen ose ushtrojnë veprimtari pa pasur nevojë të pajisen me një leje pune.

Rezidentët e përhershëm kanë të drejta për arsim e sigurim shoqëror njëlloj si shtetasit shqiptarë.

Neni 64

Detyrimi i të huajit për të dhënë informacione

Të huajit mund t'i kërkohet të japë informacione që lidhen me motivin e hyrjes, qëndrimit e veprimtarisë së tij në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacione të tjera që konsiderohen të nevojshme për të sqaruar se i huaji nuk përfshihet në ndalimet e parashikuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji. Mosparaqitja ose refuzimi për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund të përbëjë shkak për refuzimin ose anulimin e një leje ose vize të dhënë.

Neni 65

Përgjegjësia e personave që transportojnë të huaj

Personi që ka bërë të mundur hyrjen e një të huaji në Republikën e Shqipërisë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, detyrohet të paguajë shpenzimet për kthimin e të huajit në shtetin e origjinës së tij, në shtetin që i ka lëshuar pasaportën, në shtetin prej nga u transportua, ose në një shtet tjetër ku i huaji ka lejen e nevojshme për të hyrë prej autoriteteve të atij vendi.

Pronarit ose poseduesit të mjetit të transportit nuk do t'i jepet licencë, ose do t'i hiqet ajo, në rast se e ka, në qoftë se ai nuk shlyen detyrimin si më sipër brenda 6 muajve nga koha e njoftimit. Një detyrim i tillë anulohet nëse i huaji pajiset me leje qëndrimi ose i jepet statusi i refugjatit.

Pronari ose poseduesi i një mjeti transporti është i detyruar të paraqesë pranë Ministrisë së Rendit Publik listën e plotë e të saktë të personave të huaj që transporton.

KREU VI

DISPOZITA MBI ASPEKTE ADMINISTRATIVE

Neni 66

Regjistrimi në polici

Regjistrohen në polici vetëm të huajt që synojnë të qëndrojnë në Shqipëri jo më pak se një vit, dhe kur ka intervale mungese, deri në tre muaj. Regjistrimi kryhet jo më vonë se 10 ditë pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë. Pavarësisht nga përcaktimi në këtë paragraf, për arsye të sigurimit kombëtar e sigurimit publik, Ministri i Rendit Publik mund të urdhërojë regjistrimin në polici.

Regjistrohen në polici vetëm me urdhër të Ministrit të Rendit Publik pesonat e mëposhtëm:

1.fetarët;

2.pjesëtarë të një ekuipazhi;

3.të huaj të angazhuar nga institucionet publike.

Nuk regjistrohen në polici:

1.personat nën 16 vjeç;

2.personeli i përfaqësive të huaja dhe të punësuarit nga diplomatët e huaj.

Regjistrimi në polici përfshin të dhënat për personin e huaj sipas përcaktimit në aktet nënligjore, si dhe shenjat e gishtërinjve.

Neni 67

Karta për të huajt

Ministria e Rendit Publik do të pajisë me kartë për të huajt personat e huaj mbi 16 vjeç që janë rezidentë në Shqipëri për më tepër se një vit. Kjo kartë rinovohet çdo vit. Për të huajin që nuk zotëron dhe nuk mund të pajiset me pasaportë për të huajt, është e mjaftueshme karta e të huajit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 68

Pasaporta për të huajt

Rregullat për të pajisur të huajt me pasaportë për të huaj, përcaktohen nga Ministri i Rendit Publik. Disponimi i një pasaporte të tillë, edhe kur i huaji largohet përkohësisht nga Republika e Shqipërisë, i jep atij të drejtën e kthimit brenda periudhës së vlefshmërisë së këtij dokumenti. Kufizimet për lëvizjen me këto pasaporta janë të njëjta me kufizimet që zbatohen për shtetasit shqiptarë.

Pasaporta për të huajt është e vlefshme për dy vjet. Të drejtën për pajisje me këtë pasaportë e kanë:

1.të huajt me leje të përhershme qëndrimi;

2.të huajt me status refugjati;

3.të huajt me leje qëndrimi 5-vjeçare ose të huajt me origjinë shqiptare me leje të përkohshme, të cilët kanë respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi dhe që nuk kanë mundësi të pajisen me pasaportë ose dokument udhëtimi nga shteti i origjinës ose ndonjë shtet tjetër.

Neni 69

Zëvendësimi i dokumentave të humbura

Humbja e pasaportës për të huajt, kartës së të huajit ose ndonjë dokumenti tjetër të lëshuar nga autoritetet e imigracionit, njoftohet brenda 24 orësh tek autoriteti lëshues ose policia vendore. I huaji mund të pajiset përsëri pas dy muajsh me dokumentet e mësipërme, nëse vërteton se humbja ka ndodhur për shkaqe të justifikuara.

Në rast humbjeje jashtë shtetit të pasaportës për të huajt lëshuar nga autoritetet shqiptare, përfaqësia shqiptare jashtë shtetit autorizohet të pajisë të huajt me leje kalimi për t'u kthyer në Republikën e Shqipërisë, kur autoritetet e imigracionit japin konfirmimin për lëshimin e kësaj leje-kalimi.

I huaji, edhe për humbjen e dokumenteve të tjera të lëshuara nga shteti i origjinës ose një shtet tjetër, duhet të njoftojë brenda tre ditësh.

Neni 70

Administrimi i dokumenteve të parregullta

Pasaportat ose dokumentet e dyshimta, të falsifikuara ose pasaportat që mund të jenë të rregullta, por disponohen jo nga personat e duhur, mund të bllokohen dhe, me përjashtim të dokumenteve të falsifikuara të cilat konfiskohen, i dërgohen organit që i ka lëshuar nëpërmjet

Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Autoritetet e Ministrisë së Rendit Publik mund të bllokojnë pasaportën e të huajit për sqarimin e dyshimeve për shkelje të dispozitave të këtij ligji. Pasaporta i merret të huajit me vendim formal përkundrejt një vërtetimi që i lëshohet të huajit për këtë veprim. I huaji ka të drejtë të bëjë ankim vetëm kundër vendimit, si pasojë e të cilit u mbajt pasaporta.

Pasaporta mund të bllokohet, sipas përcaktimit në këtë nen, deri në fillimin e procedurave ligjore ose administrative dhe u dorëzohet organeve kompetente për këto procedura. Në përfundim të këtyre procedurave, pasaporta i kthehet të huajit nëse:

1.është e rregullt;

2.qëndrimi i mëtejshëm i të huajit në Republikën e Shqipërisë do të konsiderohet i ligjshëm;

3.është paguar gjoba ose është vuajtur dënimi.

Karta e të huajit, leja e qëndrimit, leja e punës, pasaporta për të huaj, i merren të huajit nëse janë shpallur të pavlefshme.

Në rast dëbimi, pasaporta e rregullt i kthehet vetëm në momentin e largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 71

Detyrat e autoriteteve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë

Autoritetet e Ministrisë së rendit Publik janë përgjegjëse për trajtimin e të huajve, dhënien e lejes së qëndrimit, lëshimin e dokumenteve të identifikimit ose udhëtimit të të huajve sipas këtij ligji.

Organet e policisë në kufi kanë përgjegjësinë e dhënies së vizës në kufi, refuzimin e hyrjes, kthimin prapa të të huajve, anulimin e vizës, ndalimin e largimit e masat e tjera lidhur me procedurat për të huajt që u ngarkojnë dispozitat e këtij ligji e aktet në zbatim të tij.

Neni 72

Komiteti Këshillues për të Huajt

Këshilli i Ministrave për çështjet që lidhen me të huajt emëron një Komitet Këshillues për të Huajt të përbërë nga 5 persona. Kryetari i këtij Komiteti rekomandohet të jetë një jurist i njohur dhe caktohet nga Këshilli i Ministrave. Nuk mund të jenë anëtarë të këtij Komiteti nëpunësit e Këshillit të Ministrave

Komiteti ka të drejtë të kërkojë nga çdo person informacione që i shërbejnë ushtrimit të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj. Ai bën analiza e jep rekomandime për politikat që ndiqen për të huajt e gjendjen e tyre në Republikën e Shqipërisë. Ky Komitet ndjek zbatimin e këtij ligji dhe i jep rekomandime Ministrit të Rendit Publik.

Neni 73

Raportimi i Ministrit të Rendit Publik para Kuvendit

Ministri i Rendit Publik raporton periodikisht para komisioneve parlamentare. Ai vë në dijeni ato për numrin, shtetësinë e kombësinë e të huajve që kanë hyrë e dalë, sa prej tyre kanë marrë leje qëndrimi apo status refugjati, numrin e të huajve që mendohet të kenë hyrë ilegalisht dhe të huajve të larguar, numrin e të huajve që i janë nënshtruar ekzekutimit të menjëhershëm të një urdhri largimi, numrin e të huajve të larguar apo dëbuar pa pasur të drejtën të bëjnë ankim në gjykatë sipas këtij ligji, mbi pasojat dhe efektin që kanë pasur elementë të ndryshëm të imigracionit lidhur me rendin, sigurimin publik, zhvillimin ekonomik, sferën sociale e humane, si dhe rekomandimet për politikën që do ndiqet në të ardhmen.

Neni 74
Kontrolli i të huajve

Kontrolli i të huajve që kërkojnë të hyjnë ose qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë kryhet nga policia, e cila ka të drejtë:

1. të kërkojë informacione për hyrjen e qëndrimin e të huajit në Shqipëri, për motivin e veprimtarisë që do kryejë, periudhën që do të qëndrojë, fakte që lidhen me përshtatshmërinë e të huajit për qëndrimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji;

2. të bllokojë dokumentet e të huajit, përfshi pasaportën, për të verifikuar identitetin e shtetësinë e personit ose për arsye të tjera që lidhen me plotësimin e kushteve të të huajit për të hyrë e qëndruar në Republikën e Shqipërisë;

3. të verifikojë dokumente kur dyshohet vërtetësia e tyre dhe kur është e nevojshme mund të caktojë edhe ekspertë;

4. t'u kërkojë, nëse është e nevojshme, përfaqësive të huaja në Tiranë ose përfaqësive shqiptare jashtë shtetit, verifikim të identitetit ose të një dokumenti të paraqitur nga i huaji;

5. të bëjë kontrollin fizik të të huajve.

Çdo i huaj, përveç personave të parashikuar në paragrafin 2 të nenit 66 të këtij ligji, duhet të paraqitet te policia për inspektim. Kur një i huaj tenton të shmaget, ai i nënshtrohet një kontrolli të imët.

Neni 75
Masa e shoqërimit të detyrueshëm

Policia ka të drejtë të marrë ndaj të huajit masën e shoqërimit të detyrueshëm ose vendosjen e një azilkërkuesi në vendqëndrimin tranzit për të huaj, nëse:

1. i huaji nuk arrin të bindë autoritetin kompetent për legjitimitetin e hyrjes e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, për identitetin e tij ose që ka një vendbanim apo disponon mjete jetese;

2. është e nevojshme si masë për të garantuar dëbimin e të huajit, i cili është në pritje të shqyrtimit të pranimit ose ankimit kundër një vendimi të dhënë dhe mund t'i shmanget vendimit të mundshëm të largimit ose dëbimit;

3. ka refuzuar të largohet ose ka deklaruar se nuk do të largohet, ndonëse qëndrimi i tij nuk është i ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

4.është fshehur ose i është shmangur një urdhri largimi ose dëbimi.

Neni 76
Detyrime dhe kufizime për të huajt

Të huajit i kufizohet banimi ose qarkullimi në një zonë të caktuar për arsye të sigurimit kombëtar e publik sipas përcaktimit në aktet nënligjore.

I huaji duhet të njoftojë ndryshimin e banesës brenda tri ditësh.

I huaji i nënshtrohet kontrollit financiar nga organet financiare ose kontrolle të tjera të autorizuara nga autoritetet e imigracionit, sipas procedurave përcaktuar në këtë ligj.

I huaji mban me vete dhe i paraqet autoriteteve kompetente kartën e të huajit kur i kërkohet.

Të huajit mund t'i kërkohet nga Ministri i Rendit Publik:

1. të njoftojë autoritetet kompetente brenda një periudhe të caktuar kohe pas arritjes në

Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në aktet në zbatim të këtij ligji;

2. të paraqitet periodikisht tek autoritetet e policisë, nëse drejtori i saj e konsideron këtë të nevojshme në interes të sigurimit publik ose sigurimit kombëtar.

Përjashtohet nga detyrimet e mësipërme i huaji me leje të përhershme qëndrimi dhe me status refugjati.

Neni 77

Kundravajtjet administrative

Do të konsiderohet kundravajtje administrative dhe do të dënohet me gjobë në rastet kur:

1. I huaji kundërshton ose nuk përmbush kërkesat e autoriteteve për verifikim identiteti, shtetësie ose lidhur me çështje të tjera konform këtij ligji dhe akteve në zbatim të tij;

2. I huaji përfton apo përdor vizë, leje, dokumente, kartë në funksion të hyrjes, qëndrimit apo daljes, që nuk janë nxjerrë apo nuk janë përcaktuar për t'u përdorur nga ky person;

3. I huaji pretendon për arsye abuzive se është shtetas shqiptar ose prezantohet nën një identitet ose me shtetësi të rreme;

4. I huaji nuk dorëzon deri 60 ditë pas njoftimit për anulimin ose zhvleftësimin nga organet e imigracionit të një karte të të huajit, leje qëndrimi e leje pune;

5. I huaji paraqet të dhëna të rreme për regjistrim, bën një deklaratë të rreme në një aplikim për lejeje hyrje apo qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, me qëllimin për të siguruar marrjen e një lejeje të tillë për veten e tij apo për dikë tjetër;

6. I huaji shkel afate të përcaktuara në këtë ligj, nuk njofton apo informon për çështje, përcaktuar në këtë ligj;

7. I huaji nuk disponon pasaportë ose dokument identiteti, me përjashtim të personave të huaj azilkërkues;

8. Persona shqiptarë ose të huaj pranojnë të strehojnë ose të mbështesin të huaj, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, pa raportuar tek autoritetet e imigracionit, që nuk mbajnë regjistër të dhënash për të huajin, sipas këtij ligji e akteve në zbatim të tij, që nuk u japin të dhënat inspektorëve të ngarkuar me zbatimin e dispozitave të këtij ligji, mbajnë e abuzojnë me pasaportën e të huajit;

9. I huaji humb pasaportën për të huajt ose dokumentet e lëshuar nga autoritetet e imigracionit dhe nuk njofton brenda afatit të parashikuar;

10. I huaji nuk paraqitet për ekzaminim tek inspektori sanitar shtetëror brenda 10 ditësh pas njoftimit të kësaj kërkese të organeve kompetente;

11. I huaji ushtron veprimtari të ndryshme nga ai për të cilin ka marrë lejen nga organet kompetente ose qëndron në Republikën e Shqipërisë për një motiv të ndryshëm nga ai për të cilën i është lëshuar leja e qëndrimit ose viza;

12. Organet shtetërore, personat publikë, juridikë ose fizikë nuk njoftojnë për ato që përcaktojnë dispozitat e këtij ligji;

13. Transportuesit nuk raportojnë ose nuk paraqesin në mënyrë të plotë e të saktë listën e personelit dhe të udhëtarëve;

14. Prindrit ose kujdestarët ligjorë nuk kryejnë përgjegjësinë e tyre ligjore lidhur me dispozitat e këtij ligji për fëmijët nën 16 vjeç;

15. I huaji hyn në Republikën e Shqipërisë ose largohet prej saj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo akteve në zbatim të tij;

16. I huaji largohet në drejtim të paditur, largohet pa njoftuar nga vendqëndrimi tranzit për refugjatët ose tenton t'i shmanget ekzekutimit të një urdhri largimi ose dëbimi.

Shkeljet e parashikuara në pikat e këtij neni dënohen me gjobë nga 10 000 deri në 200 000 lekë nga policia, sipas përcaktimeve që do të bëhen në aktet e nxjerra për zbatimin e këtij ligji.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi kundër vendimeve të dënimit dhe

ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Kundër vendimit për vënien e gjobës mund të bëhet ankim tek organi direkt më i lartë ose në gjykatën e rrethit, vendimi i të cilëve është i formës së prerë.

ASPEKTE FINANCIARE

Neni 78
Pagimi i garancisë për të huajt

Nëse i huaji, që kërkon vizë ose një leje qëndrimi, dyshohet se mund të bëhet barrë publike, viza ose leja e qëndrimit mund t'i lëshohet pasi i huaji ose garanti i tij në Shqipëri ka paguar garancinë në bazë të përcaktimeve në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Garancia paguhet tek autoritetet e imigracionit. Kjo shumë i kthehet të huajit brenda 4 muajsh nëse pajiset me leje qëndrimi ose largohet brenda afateve të ligjshme nga Republika e Shqipërisë. Ministri i Rendit Publik mund të vendosë që kjo shumë të bllokohet deri në përfundim të afatit të një lejeje qëndrimi të përkohshme, por jo më shumë se një vit nga depozitimi i saj.

Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave përcaktojnë çdo vit limitet financiare si minimum i të ardhurave për një të huaj, limiti ditor i një turisti ose vizitori etj.

Neni 79
Taksat për hyrjen e të huajve

Të huajt që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë paguajnë taksa për të gjitha shërbimet administrative sipas ligjeve shqiptare në fuqi

Neni 80
Përdorimi i të ardhurave të nxjerra nga tarifat e të huajve

Të ardhurat e marra sipas përcaktimeve në këtë ligj depozitohen në llogarinë e thesarit dhe përdorimi i tyre i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të ligjit organik të buxhetit.

Neni 81
Shpenzimet për kthimin e të huajve

Shpenzimet për kthimin e të huajit përfshijnë:

1. Udhëtimin e të huajit deri në destinacion;
2. Shpenzimet administrative për masat lidhur me largimin ose dëbimin e të huajit, shpenzimet për përkthim, strehim, ushqim e furnizime të tjera;
3. Shpenzimet që mund të duhen për një shoqërim administrativ përfshi edhe shpenzimet vetjake.

Shpenzimet për kthimin prapa të një të huaji mund t'i paguajë:

1. I huaji;
2. Garanti në Shqipëri;
3. Transportuesi, në rast se i huaji është transportuar për të hyrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
4. Punëdhënësi, nëse e ka punësuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

I huaji mund të kthehet prapa me shpenzimet e shtetit të cilat duhet të rimbursohen në rastin më të parë sipas përcaktimit në këtë nen. Autoritetet e imigracionit marrin masat përkatëse kundrejt personave përgjegjës duke u bllokuar para, dokumente bankare, bileta ose sende të tjera me vlerë sipas përcaktimeve në aktet në zbatim të këtij ligji, deri në masën e nevojshme për të

siguruar mbulimin e kostos, përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 82
Administrimi i të dhënave në lidhje me të huajt

Të dhënat ose informacioni i mbledhur, lidhur me statusin dhe situatën e të huajit ose në funksion të zbatimit të këtij ligji, mund t'u kalohet organeve të tjera të shtetit ose organizmave të huaja me autorizim të Ministrit të Rendit Publik. Ai mund të mos japë ose kufizojë sa më sipër në interes të sigurimit kombëtar ose sigurimit publik.

Informacionet e përcaktuara më sipër nuk do t'u kalohen organeve apo personave të tjerë nëse cenojnë jetën private të të huajit dhe nuk lidhen esencialisht me qëllimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Neni 83
Akte në zbatim të këtij ligji

Ministri i Rendit Publik të përgatisë dhe t'i paraqesë Këshillit të Ministrave aktet nënligjore lidhur me rregullat për:

1.aplikimin, kushtet për t'u plotësuar, shqyrtimin, miratimin e refuzimin, zgjatjen, ankimin e rishqyrtimin e kërkesës (edhe përfaqësimi i autoriteteve në gjyq) për vizë, leje qëndrimi, kërkesën për azil, hyrjen në kufi, dokumentet, provat e informacionin që kërkohen;

2.detyrimin e regjistrimit në polici, pajisjen me kartën e të huajit, pasaportë e dokument tjetër, rregullat e lëshimit, zgjatjen e afatit, humbjen e ripajisjen;

3.administrimin dhe mbajtjen e të dhënave nga hotelet etj., siç përcaktohet në këtë ligj;

4.inspektimin në kufi e terren, ndëshkimet administrative, masat e sigurimit në rast dëbimi, ndalimi ose qëndrimi në vendqëndrimin tranzit për të huajt, rregullat e administrimit të këtijvendqëndrimi, kontrollin, verifikimin e bllokimin e dokumenteve të të huajit;

5.formën e vizës e të lejes së qëndrimit.

Ministri i Rendit Publik përcakton rregullat për ekzaminimin ose intervistimin e të huajve, njoftimin e të huajve ose palëve të interesuara dhe çështje të tjera që i ngarkojnë dispozitat e këtij ligji.

Ministri i Rendit Publik me propozim të Komitetit Këshillues për të Huajt, përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave, aktin nënligjor me përcaktimin për vendet, shtetasit e të cilave çlirohen nga kërkesa e detyrueshme paraprake për vizë ose e marrin vizën në kufi, si dhe për vendet, shtetasit e të cilave çlirohen nga detyrimi për të paraqitur pasaportë në hyrje.

Ministri i Punëve të Jashtme përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor për pajisjen e personelit diplomatik e konsullor, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, me viza diplomatike dhe kartë qëndrimi.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor për lëshimin e lejeve të punës e inspektimin e çështjeve lidhur me punësimin e të huajve e ushtrimin e veprimtarive të biznesit.

Neni 84
Afati i miratimit të akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenin e 83 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 85
Shfuqizimi i dispozitave të ligjit "Për Migracionin"

Dispozitat lidhur me imigracionin të parashikuara në ligjin nr.7939, datë 25.5.1995 "Për Migracionin" shfuqizohen.

Neni 86
Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2394, datë 18.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Kjo eshte kopje akti dhe ne perputhje me Udhezimin nr.8089,date 22.11.2006 te Ministrit te Drejtesise dhe Ministrit te financave çmimi eshte 10 leke per flete.
Çmimi i kopjes se ketij akti eshte 13 flete x 10 leke = 130 leke